

Jeta e beqarit (pjesa 4)

Potencialet e Beqarit

Në Detroit, një djalë me emrin Xhon ishte lodhur nga shitësit e drogës që e shqetësonin lagjen e tij. Ata përdornin një shtëpi të braktisur afër shtëpisë së tij për të përzierë kokainën dhe drogëra të tjera. Pas disa vitesh përpjekjesh me bashkinë që të merrte masa, kur pa se ata nuk po bënë asgjë, Xhoni vendosi të vepronte vetë. Ai shkoi në një dyqan ndërtimi, bleu dërrasa, çekiç, dhe gozhdë, dhe filloi të bllokonte shtëpinë me dërrasa për të mbuluar të gjitha dyert dhe dritaret. Pasi përfundoi me bllokimin e shtëpisë, ai pastroi gjithashtu oborrin e saj. Disa fqinjë e panë çfarë po bënte dhe u bashkuan me të. Pasi punuan për disa orë, ata e bllokuan shtëpinë mirë dhe e pastruan oborrin plotësisht. Më vonë atë natë, kur shitësit e drogës erdhën, ata gjetën shtëpinë të bllokuar dhe nuk arritën të hynin brenda. Si rezultat, ata u larguan dhe nuk u kthyen më në atë lagje.

Një djalë i vetëm ndryshoi një lagje të tërë sepse vendosi të vepronte për atë që pa. Ai nuk tha: "Kjo nuk është puna ime, është e bashkisë," por përkundrazi, tha: "Unë do të bëj diçka për këtë." Kjo e vërtetë e thjeshtë frymëzoi shumë të rinj që të bashkoheshin për të ndaluar përhapjen e kësaj plage në qytetin e tyre dhe në të gjitha lagjet.

Falë Xhonit, një djalë, një i ri i vetëm, tani qindra e mijëra vullnetarë kanë kontribuar për pastrimin dhe rikonstruksionin e të gjithë qytetit, duke e bërë atë një vend më të mirë për të jetuar. Ata madje ndërtuan mbi 100 shtëpi të reja për familjet me të ardhura të ulëta. E gjithë kjo nisi nga nisma e një djali të ri djali beqar.

Nuk ka potencial më të madh se ai që ka në jetën e një beqari, kur ai fokusohet për të bërë diçka. Ka potencial të madh në jetën tënde. Ajo që duhet të bëjmë është të zbatojmë idetë që na jep Perëndia.

Sot unë dua që të shohim se si ta jetoni në maksimum potencialin tuaj. Do të ndaj me ju tre parime nga Bibla – nga Fjala e Perëndisë – që na mësojnë se si të arrijmë maksimumin nga jeta jonë. Si të kesh një jetë që bie në sy, që lë gjurmë? Si të sjellësh ndryshim në jetën tënde? Jo vetëm të zësh vend diku për të jetuar dhe një ditë të vdesësh, por të bësh diçka të veçantë me këtë jetë që ke.

1. Unë duhet të pranoj thirrjen që ka Perëndia për mua.

Romakëve 8:28 *'Dhe ne e dimë se të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.'*

Bibla thotë se Zoti ka një qëllim për jetën tuaj. Ne kemi folur shpesh për 5 qëllimet që ne të gjithë i kemi të përbashkëta. Por Perëndia ka një qëllim unik

për të cilin të krijoj dhe që të ka thirrur për ta përmbushur këtë qëllim. Çdo njeri në botë është i thirrur nga Perëndia. Por jo të gjithë e ngrenë telefonin për t'u përgjigjur thirrjes së Tij. Jo vetëm pastorët, misionarët, priftërinjtë, murgeshat, apo të tjerët në këtë kategori janë thirrur nga Perëndia. Ti je i thirrur nga Perëndia. Ti je thirrur nga Zoti për të përmbushur qëllimin për të cilin Ai të ka krijuar. Sepse ti je krijuar në mënyrë unike.

Ky qëllim që Perëndia ka për jetën tënde, ekziston pavarësisht nëse je beqar apo i martuar. Sot ne po përfundojmë serinë "Jeta e Beqarit". Tek Mateu 19, Jezusi e bën shumë të qartë se martesë nuk është për të gjithë. Nuk është. Jezusi tha se disa, qysh nga lindja, as që e mendojnë martesën; të tjerë ngelen pa u martuar sepse nuk i ka kërkuar kush të martohen—ose i kanë kërkuar, por nuk kanë dashur. Ka edhe disa që kanë vendosur të mos martohen dhe të merren me punët e Mbretërisë së Perëndisë. Dëgjo si tha Jezusi:

Mateu 19:12 *'Sepse ka eunukë që kanë lindur të tillë nga barku i nënës; ka eunukë që janë bërë eunukë nga njerëzit, dhe ka eunukë që janë bërë vet eunukë për mbretërinë e qiejve. Ai që mund ta kuptojë, le ta kuptojë'.*

Nuk mund t'i fusësh të gjithë beqarët në një kategori. Në lidhje me beqarët, Perëndia ka thirrje të ndryshme; le të shikojmë:

3 Llojet e Beqarëve:

1. Beqarë që janë të tillë nga lindja. Ka disa njerëz që janë formuar nga Perëndia për ta jetuar jetën beqar. Janë të formuar në atë formë dhe nuk e kanë atë dëshirë që u djeg përbrenda, "Ah, sikur të isha martuar." Ata nuk shëtisin vazhdimisht me radarin ndezur për të parë se me kë do të martohen ose kush i përshtatet. Jo, nuk janë të tillë.

Nëse njihni dikë të tillë, mos e përbuzni as mos e shtyni të martohet. Ai nuk është njeri i çuditshëm; është krijuar nga Perëndia. Zoti ka krijuar çdo njeri në mënyrën që është për qëllimin e Tij, duke ditur se Ai ka një qëllim të veçantë për çdo person. Po si e dimë me siguri që Perëndia e ka formuar një person të tillë për të qenë gjithmonë beqar? E dimë sepse Bibla flet për dhuntinë e beqarisë. Bibla thotë se ka një dhunti të veçantë beqarie.

Le ta lexojmë: apostulli Pali e kishte këtë dhunti.

1 e Korintasve 7:7 *'sepse do të doja që të gjithë njerëzit të ishin si unë (beqarë); por secili ka dhunti të veçantë nga Perëndia, njëri kështu (dhuntinë e martesës) dhe tjetri ashtu (dhuntinë e beqarisë).'*

Por, pyetja e madhe është: nëse ti je beqar, si mund ta dish nëse e ke këtë dhunti apo jo? Ka një tregues shumë praktik për ta marrë vesh nëse e ke këtë dhunti. Nëse ti e ke këtë dhunti, do të thotë se mund të jetosh gjithë jetën tënde pa seks,

dhe kjo nuk të acaron dhe nuk të bezdis. Nëse ke përleshje brenda vetes se nuk po e plotëson dot këtë nevojë seksuale, kjo është shenjë që ti nuk e ke këtë dhunti. Shumë pak njerëz e kanë këtë dhunti, por e vërteta është se Perëndia ua jep disa njerëzve këtë dhunti të tillë.

Dhe ata të cilëve Ai u ka dhënë këtë dhunti janë ndër persona që kanë sjellë ndikimin më të madh në botë. Ata që kanë pasur arritjet më të mëdha në këtë botë shpesh kanë qenë beqarë. Disa nga shkrimtarët më të mëdhenj, shpikësit, shkencëtarët, artistët dhe misionarët ishin beqarë.

Nga historia, Mbretëresha Elizabeta ishte beqare dhe ajo mbretëroi në Epokën e Artë të Anglisë. Në muzikë, Beethoven, kompozitori i madh, ishte beqar. Xhan Dark, e cila drejtoi ushtrinë franceze, ishte një grua e vetme. Susan B. Anthony, e cila fitoi të drejtën e grave për të votuar në Amerikë, gjithashtu ishte beqare. Lottie Moon, e cila çoi Fjalën e Zotit në Kinë, ishte beqare. Në shekullin e 20-të, Corrie ten Boom, e cila fshehu të krishterë hebrenj nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjithashtu ishte beqare. Nënë Tereza, e cila punoi në lagjet e varfëra të Kalkutës, ishte gjithashtu beqare. Etj.

Bibla është e mbushur me histori të burrave dhe grave që Perëndia i përdori për të sjellë ndikim të jashtëzakonshëm në këtë botë. Në Dhjatën e Vjetër kemi Deborën dhe Isakun. Në Dhjatën e Re, Gjoni Pagëzori ishte beqar. Apostulli Pal, misionari më i madh, ka qenë gjithashtu beqar. Dhe meqë ra fjala, personi më i rëndësishëm i historisë së njerëzimit, Jezus Krishti, ishte beqar.

Pra, duket se kur Zoti i jep dikujt këtë dhunti të veçantë në jetën e tij, Ai do ta përdorë atë person në mënyrë të veçantë për të sjellë shumë ndikim në botë. Kështu, disa njerëz janë beqarë nga lindja, dhe kjo është thirrja e tyre nga Perëndia.

2. Beqarët që janë të tillë me zgjedhjen e tyre të lirë. Ky grup mund të martohej, nëse do, por ata kanë vendosur se diçka tjetër është më e rëndësishme se martesat. A është kjo një gjë e mirë apo një gjë e keqe? Kjo varet. Varet nga arsyet pse ata vendosën se ka diçka tjetër që është më e rëndësishme se martesat. Për shembull, a është e mundur të martohesh për arsye të gabuar? Sigurisht që po. Është gjithashtu e mundur të rrish beqar për arsye të gabuara. Ka disa arsye të mira për të qëndruar beqar me zgjedhje të lirë, por ka edhe disa arsye të këqija për të qëndruar beqar me zgjedhje të lirë.

Arsyet që janë arsye të këqija, për shembull, kur ti thua: "Unë jam shumë i zënë, sepse dua të bëj edhe ca lekë." Ka shumë persona që thonë, "Nuk kam kohë të dal, fejohej, martohej... më duhet të bëj edhe ca lekë. Dua të fitoj disa gjëra, pastaj do të martohej." Kjo është një arsye e gabuar. Pse? Sepse jeta nuk është për ca gjëra. Thelbi i jetës është marrëdhënia. Dhe të shpenzosh një pjesë të jetës tënde për të marrë më shumë gjëra, duke shpresuar se do të të japin një

marrëdhënie më të mirë, kjo është çmenduri. Kjo nuk është një arsye e mirë. Jezusi tha, "Jeta nuk qëndron në bollëkun e gjërave." Nëse e do jetën, jeta është në marrëdhënie. Pra, mos prit që të fillosh një marrëdhënie vetëm pasi të kesh më shumë gjëra. Kjo është një arsye e gabuar për të qëndruar edhe ca kohë beqar.

Një arsye tjetër e gabuar për të qëndruar beqar është kur ti thua: "Dua një jetë pa përgjegjësi. Unë nuk dua aq shumë përgjegjësi; martesë është përgjegjësi e madhe. Unë do të jetoj jetën time." Kjo është, me të vërtetë, më shumë se çdo gjë tjetër, një shenjë papjekurie. Ai që ka frikë nga përgjegjësitë është i papjekur.

Apo dikush i thotë vetes: "Unë mendoj se do të qëndroj beqar, sepse nuk dua të bëj aq shumë kompromise sa bëjnë të martuarit." Ti shikon të martuarit dhe thua: "Nëse martohem, nuk do të bëj më atë që dua unë; kështu që më mirë të rri beqar dhe të bëj çfarë të dua." Por, po nuk bërë kompromise, po nuk kalove sfida në jetën e përditshme, nuk behesh më i pjekur, nuk forcohet karakteri yt, nuk rritesh.

Apo një arsye tjetër e gabuar për të qëndruar beqar: "Pse të martohem, unë seks po bëj, qejf po bëj, çfarë më duhet martesë?!" Arsyeja numër 1 pse njerëzit qëndrojnë beqar është frika - frika e përkushtimit. Apo frika që mund të lëndohen përsëri. Apo frika e dështimit. Ne të gjithë përballemi me frikën në jetën tonë, në forma të ndryshme.

Po ti mbledh të gjitha këto që thashë më sipër, përfundimi është se arsyeja e gabuar përse disa vendosin të rrinë beqar është se janë EGOISTË. Disa njerëz zgjedhin të qëndrojnë vetëm për arsye egoiste, dhe kjo nuk është një arsye e mirë.

Por ka edhe arsye të mira për të ndenjur beqar. P.sh, dikush thotë: "Dua të përfundoj shkollën, se po u martova, do ngelem pa shkollë."

Arsyeja më e madhe për të qëndruar beqar me zgjedhje të lirë ose motivi më i lartë është për qëllime të Perëndisë. "Disa zgjedhin të mos martohen për hir të Mbretërisë së Qiellit," tha Jezusi. Ka disa prej jush që mund të thonë: "Unë do të martohem një ditë, por përsa kohë që jam beqar/re, do t'i përkushtohem Perëndisë dhe do të bëj çdo gjë që më kërkon Ai." Kjo është thirrja më e lartë që mund të ketë një beqar.

3. Beqarët që janë të tillë për shkak të rrethanave. Nuk janë të tillë nga krijimi ose zgjedhja, por vetëm për shkak të rrethanave. Shumë njerëz do të donin të martoheshin, por vetëm për shkak të rrethanave në këtë fazë të veçantë të jetës nuk janë martuar. Ata janë beqarë, dhe shumica e të rriturve beqarë bien në këtë kategori. Ata ndihen sikur janë gati për t'u martuar, por për një arsye apo një tjetër nuk po martohen dot. Ka rrethana shumë legjitime që e shkaktojnë që

ti të jesh beqar në këtë fazë të jetës tënde. Ndoshta të kanë kërkuar dorën për martesë, por s'te ka pëlqyer ai person. Dhe ndoshta nuk ke gjetur ende asnjë person që të thuash: "Ja vlen që unë t'ia përkushtoj jetën time atij djali/vajze." Kjo është arsye e duhur për të pritur edhe ca.

Dëgjo, mund të bëjmë ndonjë shaka këtu, por disa rrethana që krijon beqaria e tillë nuk janë për të qeshur fare. Ka raste divorci dhe ndarjeje. Janë shumë situata të tjera që janë të dhimbshme. Një nga ato situatat që janë të dhimbshme është ky pasazh:

1 e Korintasve 7:15 *'Nëse jobesimtari ndahet, le të ndahet; në këto raste vëllai ose motra nuk janë më të lidhur; por Perëndia na ka thirrur në paqe.'*

Nëse ai/ajo të lë për shkak se je bërë besimtar, le të ikë; ti nuk je më i lidhur me atë person. Për fat të mirë, nuk ka shumë raste të tilla këtu, por në zonat myslimane, hindu, apo me një besim tjetër tradicional të fortë, mund të ndodhin këto raste.

Kjo lloj beqarie është një situatë delikate, sidomos kur dëshiron të martohesh dhe nuk ke mundësi. Singërisht, unë dhe gruaja ime lutemi për ju të gjithë në përgjithësi, që Zoti do t'ju ndihmojë të gjeni dhe të lidheni me personin e duhur. Por lutemi me shumë forcë për personat që kanë ngelur pa dashjen e tyre akoma beqarë, dhe kemi shumë shokë/shoqe të tilla. Kjo nuk është një fazë e lehtë në jetën e tyre. Nuk ka ndonjë mënyrë të shpejtë për ta kaluar. Të dhemb zemra kur të ngelet diçka e madhe e paplotësuar, dhe jo vetëm për këtë, por në përgjithësi.

Perëndia e njeh dhimbjen e tyre. Por për ju që dëshironi të martoheni, por për çdo lloj arsyeje ndodheni në këtë fazë të jetës, ajo që dua t'ju them sot është: Mos u hidhëroni, mos e dënoni veten. Mos u zemëroni as mos mbani inat, sepse këto emocione janë shumë më të këqija se beqaria. Sepse së pari, nuk e detyron dot dikë të bjerë në dashuri me ty, dhe nuk e detyron dot dikë të rrijë i dashuruar me ty. Është zgjedhja e tyre. Nuk ndodh me imponim.

Zoti nuk e detyron një çift që të rrijë i dashuruar. Pse? Sepse Ai na ka krijuar me mundësinë e zgjedhjes së lirë. Perëndia na lejon, na jep liri për të marrë vendime, përfshirë ato të gabuara, çdo ditë, sepse ashtu na ka krijuar, të zgjedhim vetë. Ai nuk detyron askënd të bjerë ose të rrijë i dashuruar. Perëndia e ka krijuar njeriun për të dashuruar dikë, sepse ai/ajo zgjedh ta dojë atë, dhe jo sepse është i detyruar. Madje, Perëndia nuk të detyron asnjë njeri të jetojë sipas vullnetit të Tij.

Të gjitha këto gjëra janë pjesë e jetës. Të gjithë ne kemi thirrje të ndryshme. Një gjë shumë e rëndësishme është që, nëse je beqar dhe dëshiron të martohesh, mos dëgjo se çfarë të thotë bota. Mos merr në konsideratë standartet dhe opinionet e tyre. Nëse i dëgjon ata, do të biesh në një gjendje të keqe. Sepse i gjithë mesazhi

i tyre është se, nëse je beqar, je i paplotesuar ose ke probleme. Jo, kjo është një gënjeshtër dhe të dëmton shumë.

Romakëve 12:2 *'Dhe mos u konformoni me këtë botë (me standartet e kësaj bote), por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj (lejoje Perëndinë të transformojë mënyrën se si mendon), që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullneti i Perëndisë.'*

Të gjithë ne duam të dimë se cili është vullneti i Perëndisë për jetën tonë, pse jetojmë në këtë tokë. Vullneti i Tij është i mirë, është i pëlqyer, është i përsosur.

Si njihet vullneti i Perëndisë? Mos u bazo në standartin e kësaj bote, por në atë që thotë Perëndia në Bibël.

Filipianëve 4:11 *'Nuk e them këtë se jam në nevojë, sepse unë jam mësuar të kënaqem në gjendjen që jam.'*

Filipianëve 4:13 *'Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon.'*

Dëgjo si thotë Pali, “duhet të mësosh si të jesh i kënaqur.” Të jesh i kënaqur nuk vjen natyrshëm. Është diçka që mësohet. Nga natyra, ne jemi persona të pakënaqur, sepse gjithmonë duam diçka të re, diçka ndryshe, diçka më shumë. Ai tha, “mësohu si të jesh i kënaqur.” Ai që është mësuar të jetë i kënaqur, tregon shenjë pjekurie.

Cfarë do të thotë të jesh i kënaqur? Sepse ka persona që janë beqarë që s'janë të kënaqur me gjendjen që janë, ka persona që janë të martuar dhe prapë s'janë të kënaqur me gjendjen që janë.

Të jesh i kënaqur do të thotë që nuk pret që të ndryshojnë rrethanat e tua për të qenë i lumtur. Pse? Sepse lumturia është zgjedhja jote. Ti vetë e zgjedh sa i lumtur do të jesh. Nëse sot nuk je i lumtur, është sepse ashtu ke zgjedhur, sepse e ke lejuar mendjen të mendojë mendime që s'të bëjnë të lumtur. Askush nuk ta prish lumturinë ty pa e lejuar ti vetë, sepse lumturia nuk varet nga rrethanat. Nëse do të jesh i lumtur, gjithmonë do të gjesh diçka në jetën tënde për të qenë mirënjohës dhe i lumtur. Pra, kjo është të jesh i kënaqur: nuk pret që të krijohen kushtet për të qenë i lumtur, por je i kënaqur dhe i lumtur pavarësisht se në çfarë gjendje je, sepse tek ti ka gjithmonë diçka të mirë, për të cilën ti je mirënjohës.

Shpesh njerëzit kanë këtë qëndrim: “Kur të ndodhë kjo, atëherë do të jem i/e lumtur.” Beqarët thonë, “Kur të martohem, atëherë do të jem i lumtur.” Por martesë nuk është fundi i botës; ajo shënon fillimin e një etape krejt të re. Disa thonë, “Po atëherë, kur të kem fëmijë, atëherë do të jem i lumtur.” Më pas, kur ti rrisësh fëmijët, thua “kur t'i çoj në shkollë, kur të fillojnë punë, kur të martohen, kur të kenë fëmijët e tyre... kur të dal në pension.” Kështu, në jetën e tyre, krijohet një cikël ku gjithmonë ka një “kur” dhe një “pastaj.”

Perëndia thotë që kjo nuk është gjë e mirë. Njeriu duhet të jetë i kënaqur në atë gjendje ku është, ta gëzojë jetën aty ku është. Kur Zoti sjell një fazë të re, ka aq më shumë gjëra për t'u gëzuar.

Një gjë e tillë i ndodhi popullit të Izraelit. Në Bibël lexojmë që një ditë ky popull u mor peng dhe u çua në robëri në Babiloni, Irakun e sotëm, të gjithë banorët. Izraelitët menduan që kjo gjë s'do zgjaste, kështu që nuk u stabilizuan në vend. Po e merrnin jetën lehtë; nuk po punonin, nuk po mbillnin, po jetonin "sa për ta shtyrë," ashtu siç po jeton shumica e njerëzve sot.

Nëse edhe ti po jeton "sa për ta shtyrë," Perëndia thotë se kjo nuk është gjë e mirë. Perëndia u dërgoi atyre një lajmëtar, që quhej Jeremia, për t'u thënë atyre:

Jeremia 29:28 *'Në fakt ai (Perëndia) na ka dërguar fjalë në Babiloni: "Robëria do të jetë e gjatë (kështu që merreni shtruar jetën këtu), ndërtoni shtëpi dhe banoni në to, mbillni kopshte dhe hani frytet e tyre"'.*

Perëndia thotë: "Mjaft ngele duke u ankuar, mjaft ngele duke e krahasuar veten me të tjerët, mjaft e ke marrë 'të dalë ku të dalë', mjaft ngele duke fajësuar të tjerët për gjendjen tënde. Shkundu, tundu, fillo dhe jetoje jetën siç duhet. Mjaft jetove 'sa për ta shtyrë'."

Për disa mund të vlejë pjesa e vargut: *"Hidh rrënjë, stabilizohu."* Mos rri duke shpresuar se çfarë do të sjellë e nesërmja, sepse ti mund të jetosh vetëm të sotmen. E djeshmja është e kaluar, por edhe e nesërmja është imagjinare, sepse nuk e di se çfarë do të sjellë. Ajo që di ti është e sotmja. Prandaj, Bibla thotë: "Kjo është dita që Zoti ka bërë, dhe unë do të kënaqem, do të gëzohem me të."

Nëse je duke pritur diçka për të qenë i lumtur, ka shumë mundësi që nuk do të jesh kurrë i/e lumtur. Sepse lumturia është zgjedhje, nuk janë rrethanat që të bëjnë të lumtur. Kjo ishte për tre llojet e beqarëve, por le të vazhdojmë më poshtë.

2. Unë duhet ta përdor lirinë që kam për Perëndinë.

Sigurisht që këtu, Perëndia na ka dhënë liri të plotë. Pavarësisht nëse drejtuesit tanë janë të mirë apo të këqinj, të paktën nuk jetojmë në ndonjë lloj diktature si shumë pjesë të tjera të botës; ne kemi liri. Prandaj, duhet të japim maksimumin nga jeta jonë, qofshim beqarë apo të martuar. Pasazhi më i mirë për këtë është...

1 e Korintasve 7:32-34

'Dhe unë dëshiroj që ju të jeni pa merak. I pamartuari merakoset për gjërat e Zotit, si mund t'i pëlqejë Zotit; por i martuari merakoset për gjërat e botës, si mund t'i pëlqejë gruas së tij. Ka dallim gruaja nga virgjëresha; e pamartuara kujdeset për gjërat e Zotit që të jetë e shenjtë në trup e në frymë, kurse e martuara kujdeset për gjërat e botës, si mund t'i pëlqejë burrit.'

Pali thotë që ka të mira në të dyja situatat, si kur je i martuar, ashtu edhe kur je beqar. Në të dyja rastet, ka përgjegjësi që duhen përmbushur. Ti thjesht duhet të vendosësh se në cilën anë të gardhit dëshiron të qëndrosh—beqar apo i martuar—sepse të dyja kanë të mirat dhe përgjegjësitë e tyre.

Le të lutemi.